

JAMARBËR HOXHA

AUVERNAMON

(LULËKUQJA)

POEZI

BOTIMET TOENA

JAMARBËR HOXHA

AUVERNAMON
(LULËKUQJA)

poezi

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2021

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Anrila Spahija

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Nevzat Bejtuli Kica

ISBN 978-9928-348-19-7

© Autori *dhe* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

Në vend të parathënies

Ndijimet që na përcjellin shqisat mund të shndërrohen në përshtypje, kurse ndjesitë që na lindin s' dihet sesi apo përse, na shpien në përjetime, prandaj përshtypjet, me kalimin e kohës ose me ndryshimin e një situate të dhënë, mund të megjulohen, madje edhe të shuhen, kurse përjetimet kurrsesi, dhe kjo është tipike sidomos për artistët ose për ata që, të paktën, kanë shpirt artisti.

I tillë më duket se është edhe rasti i një dhjetëvjeçari, pra i një adoleshenti ndryshe nga të tjerët. Po, ndryshe nga moshatarët e tij, sepse ai është diagnostikuar me autizëm. Deri sot kisha dëgjuar të flitej për fëmijë të tillë me talent në fushën e muzikës apo të pikturës, kurse këto kohët e fundit zbulova se Jamarbër Hoxha është poet, një poet që i paraqitet lexuesit të ndjeshëm me këtë vëllim të pazakontë vargjesh krejt të sinqerta.



Hasen në këto vargje një mori ndjesish që, me gjasë, do ta kredhin lexuesin empatik në një gjendje shpirtërore naive në dukje, por të aftë për t'i krijuar atij ndjesi që mund ta çojnë drejt një përjetimi befasues. I tendosur midis frikës dhe sigurisë, fobisë dhe mrekullisë, trishtimit dhe gëzimit, ditës dhe natës, errësirës dhe dritës, heshtjes dhe zërave, mbylljes brenda në shtëpi dhe daljes jashtë mureve të saj, Jamarbëri kërkon dhe lufton për të kuptuar “pse”-në e gjërave, “pse”-në e marrëdhënieve të tij me njerëzit cilëtdo e kudo qofshin ata.

Nga ana tjetër, ai nuk do ta ndiejë më shpirtin “të ditëzezuar” (sa bukur e ka krijuar këtë epitete!) as “mendjen të rënë thellë nën tokë”, prandaj shpalos pa ngurrim kredon e tij kur shkruan: “Nuk dua të zgjedh askënd / Dua të rri mes jush / Dhe të jem i lumtur” duke ngulur kështu këmbë për të flakur tej zgjedhën e autizmit, sepse vetëm dashuria për të gjithë njerëzit dhe jo vetëm për disa të bën vërtet të lirë, të mirë, të ripërtërirë.

Gjithsesi, Jamarbëri të jep përshtypjen sikur nuk ushqen iluzione lidhur me gjendjen e tij duke shprehur brengën që ka thellë në shpirt me këtë poezi të shkurtër, por, ah, sa kuptimplote:



*Qielli është si në ëndërr,
Unë jam si drita,
Unë jam në hije,
...
Një dritë në hije.*

Edmond Tupja



Poezia e Jamarbër Hoxhës: dëshmi për vazhdimësi të jetës dhe dashurisë

Poezia, vjershat e Jamarbër Hoxhës, fëmijë dhjetë vjeç, që m'u dhanë për t'i bërë një qasje recensive, shprehin një dëshirë për vazhdimësi të jetës. Ky fëmijë me një aftësi prej të rrituri, tregon gjenialitetin e vet, dhe dëshirën për një rimëkëmbje të tij, të familjes, rrethit dhe ambientit.

Përmbledhja, për të cilën m'u dha nderi që të shkruaj ca fjalë, ngërthen periudhën diku kah viti 2017 e deri sot. Shihet qartë dëshira e autorit për të shijuar një fëmijëri të zakonit, e tillë që do t'u ngjasonte të gjithë fëmijëve të tjerë.

Mes të tjerash, Jamarbëri prek tema me të cilat zakonisht merren shkrimtarët dhe poetët e mëdhenj, siç është për shembull, ekzistenca jonë, varësia dhe pavarësia nga rrethi social që na rrethon, relacionet ndaj njerëzve, gjithësisë, universit dhe mënyrës se si ai e konceptualizon botën.



Një rrethanë të veçantë të cilën do të doja ta përshkruaja është dashuria ndaj të afërmeve të tij. Një koncept kaq kompleks dhe në shikim të parë abstrakt, siç është dashuria, në rastin e Jamarbër Hoxhës, konkretizohet. Kur them se është shumë gjë konkrete, pikërisht i referohet prindërve të tij, duke theksuar meritën e tyre për arritjet e tij, dëshirën që në të ardhmen, të jetë pavarësia ajo që do të karakterizojë tiparet e tij. Kjo të çon të mendosh se ky personalitet jeton me kriteret tash më të vendosura në shoqëri, disa prej të cilave, siç jemi të gjithë të vetëdijshëm, janë edhe të imponuara.

Tërheq vëmendjen e një kritiku letrar posaçërisht, metaforizimi i çështjes tek ky fëmijë në një moshë kaq të re, që argumenton aftësitë e tij parashikuese për të ardhmen. Ai përfundimisht dëshiron që t'i ketë prindërit e tij përgjithmonë, që t'i konsiderojë si të barabartë me të, e jo si të tillë që do të merreshin vetëm me përkujdesjen ndaj tij.

Njëra nga poezitë, vjershat, që më bëri përshtypje është fakti që ky fëmijë nuk e do autizmin, nuk e do këtë dukuri kaq të përfolur nga ata që nuk e dinë se ç'kuptim ka, nga ata që e klasifikojnë si mosmundësi personale e paaftësi njerëzore. E kundërta, pra edhe sipas Jamarbër Hoxhës, është e vërtetë. Nuk e do autizmin si dukuri që do të kërkonte kujdesin ndaj tij, por e do si dhunti.

Në këtë rast pra, dhe këtë e kanë thënë edhe ekspertët se, autizmi është dhunti nga Zoti, që u jepet personaliteteve të veçanta, e që përfaqëson aftësi që nuk mund t'i kenë të tjerët.



Kryesisht, në këto krijime poetike, ku versifikacioni nuk është i fiksuar, por është narrativ, autori tregon fakte autobiografike, të zbukuruara me çështje që metaforizohen për shkaqe stilistike, dhe që e bëjnë artin të quhet art.

Është e qartë si përfundim se unikaliteti i poezive të tij, të bën të mendosh se kemi para nesh një poet të veçantë, të bën të mendosh, se edhe të tjerët që i quajnë “autik” nuk janë aq të padëshirueshëm për shoqërinë siç i njollosin, siç na njollosin dhe na vendosin në “grupe të marginalizuara” të shoqërisë. Kjo nuk vlen për këtë poet kaq të ri. Përkundrazi, autizmi është shkas për jetë në përputhshmëri të plotë me standardet jetësore dhe konventat shoqërore.

Siç thashë, autori është narrativ, tregimtar, rrëfen për jetën: për atë se si duhet të duket modeli i një përjetimi të denjë të fëmijërisë, pa pretendime, por me imagjinatë të thellë krijimtarie, që zhvillohet në mënyrë permanente dhe të pandërprerë.

Prof. dr. Bujar Hoxha
Universiteti i Europës Juglindore, Maqedoni.



Auvernamon - Milna vodore
Lulëkuqja - Lulja vodore
Milnasil ondo a tu - Lule që të sjell gëzim

Lulëkuqja ishte një nga lulet më të preferuara të Venusit, perëndeshës romake të bukurisë dhe dashurisë. Prej shekujsh lulëkuqet janë pranuar si simbol i qetësisë, gjumit dhe paqes.

Shkenca tregon se lulëkuqja përmirëson dhe shton jetën.

Njerëzit besojnë se lulëkuqja është një nga bimët më të lashta; arkeologët gjetën farën e saj në ndërtesa nga epoka e Neolitit. Kjo lule ishte një simbol i gjumit, madje kishte një besim të tillë që kur ra nata, Morpheus erdhi në tokë, duke mbajtur në duar disa lulëkuqe. Dhe, jo më kot, sepse ka një lulëkuqe që fle - opium. Në lidhje me magjinë: në përbërjen e një ilaçi dashurie, shtriga përdorte përdorimin e bimëve të ndryshme, lule, përfshirë lulëkuqe. Kjo lule u konsiderua si një mjet i fuqishëm, veçanërisht



në punët e dashurisë. Është e këshillueshme që vetë vajza të mbledhë farat e lulëkuqes me hënën në rritje me dorën e saj të djathtë, dhe pastaj t'i mbajë këto fara me vete - atëherë dashuria me siguri do të vijë. Më parë, ajo ishte përdorur si mbrojtje nga shpirtrat e këqij. Njerëzit besonin: nëse e shpërndani në dysheme, demoni do të numërojë farat e lulëkuqes dhe në këtë kohë nuk do të dëmtojë njerëzit paqësorë.



Nuk dënohet
Një zemër
Nga gjyqi i lartë,
Sepse një zemër,
Mund të mbajë
Dashuri.

18 qershor 2017



Mjalti im

Mami im e dashur,
Të dua fort,
Dhe ti je
Kënga e një zane,
Dhe ti je
Aroma e flokëve
Prej mjalti.
Je vallë e dashuruar?
Nëse ...
Kur je e vetmuar,
Unë vij tek ty
Dhe të flas
- Maaamiii
- Oh, Jamarbër!



Mami im

Mami im e dashur,
Dhe e bukur,
Bukuria jote
Është e thellë
Ajo shndrin
Me lashtësia.

2 tetor 2019



Magjistar i vendit të lashtë

Ai është njeriu
Më i famshëm
Në të gjithë botën tonë,
Dhe çdo ditë
Është ushtarak,
Që udhëton,
Dhe i famshëm
Në të gjithë vendin e lashtë,
Si një magjistar
Me shkop magjik
Më çon në kështjella
Dhe kreshta mali,
Dhe në thellësi ujore,
Ky është babai im,
Heroi im.



Ju dua

Ju dua,
Ju dua sa gjithë universi
Ju dua sa gjithë bota,
Ju dua prindërit e mi
Ju dua,
Ju dua se jeni të lumtur
Jeni të dashur,
Ju dua,
Ju duuuuaa.

13 prill 2020



Paksa

poezi kushtuar babait tim

Paksa
Më kupton ti mua?
A më do ti?
Ti je i mirë,
Të kam zemër,
Të kam xhan.
Paksa

13 prill 2020



Fundi i poezisë

Natën e mirë Ma!
Pashë në ëndërr një dashuri
Të pashë ty në ëndërr
Të pashë të gëzuar.

8 janar 2020



Kënga ime e re titullohet "Mami"

Teksti:

Sa herë më ke lindur
E rritur, moj nëna ime e dashur.
Ti më ushqeve me gji
Dhe më bëre
Një djalë të mirë
Ti mua më rrite
Edhe më doje shumë.
O Mami im
Ti që më linde
Dhe më rrite
Dhe më ushqeve
Të kam xhan
O Mama.
Unë qaj kur jam vetëm
Pa ty dhe më
Rrjedhin lotët
Nëpër sytë e mi.



Ti më doje
Dhe unë të doja
O Mami im!
Mama, o mama
Ti më doje shumë mua
Unë e dua atë
Sepse ajo është nëna ime
Dhe ajo më lindi
E më rriti
E më ushqe
Me gjirin e saj
Ajo më donte shumë
Dhe më kishte xhan!
O Mami im!
Ti që më bërë
Një djalë të bukur
Dhe të mirë
Dhe më kënaqe
Ne ishim të lumtur
Ti më edukove
Dhe më rrite



Unë të dua ty!
Dhe nuk rrija
Vetëm pa ty
O Mami im!
Të dua Mami!

14 janar 2021



Mami im ka një rreth të artë në kokë
Dhe është e hareshme.

...

Mami im e hareshme
Me një rreth të artë në kokë.

25 shtator 2020

